



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr.83, datë 18.06.2024

PËR
VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS SË ZONJËS AULONA HAXHIRAJ,
KANDIDATE PËR MAGJISTRAT PROKURORE, E CILA DO TË DIPLOMOHET
NGA SHKOLLA E MAGJISTRATURËS NË VITIN 2024

Mbështetur në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 159 dhe 189 pika 1, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 32 dhe 35 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve” i ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Për verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatës për magjistrat prokurore zonjës Aulona Haxhiraj, e cila do të diplomohet nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2024”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Relacionit të kandidatës për t’u emëruar prokurore, zonja Aulona Haxhiraj, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të vlerësojë të përfunduar verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatës Aulona Haxhiraj.
3. Lejimin e kandidatës Aulona Haxhiraj të vijojë me procedurat e mëtejshme për emërimin e saj si prokurore.
4. Të njoftohet për këtë vendim zonja Aulona Haxhiraj dhe Shkolla e Magjistraturës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
6. U shpall në Tiranë, sot më 18.06.2024.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

Mirela Bogdani

ANËTAR

Zeqir Hoda

ANËTAR

Ledina Riza

ANËTAR

Sokol Stojani

ANËTAR

Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka



ANËTAR
Olger Eminaj

